

Universiteti “Aleksandër Xhuvani”, organizon në kuadër të 35-vjetorit të Erasmus +, takimin “Mobility Caffè”, me studentë përfitues të programit

Erasmus+ Mobility Caffè është takimi i parë i këtij formati, në kuadër të takimeve pas mobilitetit për studentët e Universitetit të Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, është bërë pjesë e programit Erasmus+ në vitin 2014 me projektin KA107, i cili mundëson mobilitetin e studentëve për të tre ciklet e studimit (Bachelor, Master, Doktoraturë, për studime dhe intership) dhe mobilitete të stafit (për mësimdhënie, trajnime, kërkim shkencor) dhe ka në fuqi 50 marrëveshje me universitetet partnere.

Universiteti i Elbasanit “Aleksandër Xhuvani”, ka qenë dhe është pjesë e shumë projekteve të ndryshme me Programin Erasmus+, duke filluar me Tempus, Erasmus Mundus, Capacity Building in Higher Education CBHE, Jean Monnet.

UE, është duke bashkëpunuar me Universitete partnere të ndryshme për lidhjen e marrëveshjeve të reja për mobilitete dhe projektet e ndryshme që janë në programin Erasmus+.





